

MJEDISI, QEVERISJA VENDORE DHE KLSH

nga Mimoza LLOJI - Kryeauditues¹e,

botuar në gazetën "Ekonomia", më 05 maj 2014.



Paketa Ligjore për Mjedisin është e bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe përbëhet nga ligjet dhe aktet normative, rregulloret, udhëzimet dhe standardet të cilat kërkojnë nga institucionet përgjegjëse, ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm, ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

Në dhjetëvjeçarin e fundit janë hartuar dhe miratuar një numër i konsiderueshëm ligjesh dhe aktesh të tjera nënligjore për mbrojtjen e mjedisit, të cilat kanë kontribuar në plotësimin e kuadrit ligjor dhe në mbështetjen më të plotë ligjore të masave parandaluese dhe rehabilituese për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimet. Kuadri ligjor i miratuar është në masën më të madhe të tij i harmonizuar me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian.

Në këtë paketë ligjore ndërthuren detyrat dhe përgjegjësitë për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi, si të institucioneve qendrore apo institucioneve në vartësi të tyre me organet e qeverisjes vendore që përfaqësojnë strukturën më të rëndësishme shtetërore për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit, duke zbatuar përgjegjësitë, të drejtat e detyrat që u jep ligji nr.8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore". si dhe ligji nr.10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit".

Shoqëria e sotme shqiptare po përballlet me transformimet e mëdha ekonomike, të shoqëruara me rritjen e konsumit prej popullsisë së të mirave materiale dhe për rrjedhojë edhe me rritjen e sasisë së mbeturinave të gjeneruara. Veç kësaj, edhe për shkak të ritmeve të larta të rritjes së popullsisë, menaxhimi i mbetjeve të ngurta

urbane është shndërruar në një sfidë të fuqishme, kryesisht në qytetet e mëdha të vendit.

Në këtë kuadër në vendin tonë për të ulur sa më shumë ndotjen mjedisore është e nevojshme që subjektet të cilat merren me trajtimin e mbetjeve, të përshtatin teknologjinë që përdorin, me politikat e Bashkimit European dhe Konventave Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Mjedisit. Strukturat e pushtetit qendror dhe vendor, duhet të bashkëpunojnë me njeri-tjetrin, për të minimizuar efektet negative që mund të sjellë përpunimi i mbetjeve, apo trajtimi i ujërave në mjedis.

Nismat kryesore që duhet të ndërmerren në këto fusha, janë rishikimi i legjislacionit dhe decentralizimi i shoqërive të ujësjellësve drejt pushtetit vendor. Në kushtet aktuale stimulimi i aktiviteteve të pastrimit, të trajtimit të mbetjeve, ndarjes në burim dhe riciklimit të tyre janë të një rëndësie të veçantë dhe një nga prioritetet e politikave të zhvillimit.

Për një mjedis sa më të pastër dhe në shërbim të komunitetit, organeve të qeverisjes vendore, u del për detyrë të ushtrojnë kompetencat që ligji ju jep në mbrojtje të mjedisit, dhe në kushtet aktuale në fushën e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane, për të rritur ndërgjegjësimin në të gjitha nivelet, duke filluar nga drejtuesit e institucioneve deri te qytetarët e thjeshtë dhe duke përfshirë gjithnjë e më shumë median, edukimin në shkolla, trajnimin e personave përgjegjës në çdo qark, bashki e komunë etj,

Me qëllim që administrimi i mbetjeve të kthehet në çështje prioritare për komunitetin, të hartojnë dhe zbatojnë planet vendore për administrimin e mbetjeve të ngurta, si pjesë të planeve lokale të veprimit në mjedis, me qëllim që nevojat e studiuara për fonde dhe burime njerëzore, të përfshihen në buxhetin respektiv si dhe fondet e siguruara duke zbatuar skema tarifore të efektshme, që përdoren për pastrimin, transportin dhe depozitimin e mbetjeve të ngurta.

Organet e Qeverisjes Vendore të impenjohen për të thithur fonde për ndërtimin e venddepozitimeve të sigurta të mbetjeve, të të gjitha niveleve, për të siguruar kontrollin mbi zotëruesit e mbetjeve, me qëllim që ata vetë, me shpenzimet e tyre, të sigurojnë grumbullimin, transportin, ruajtjen, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve të gjeneruara prej tyre, duke kontrolluar zbatimin e kushteve të vendosura në lejet mjedisore dhe në kontratat e pastrimit të qyteteve, të hartojnë dhe zbatojnë planet e veprimit dhe marrjen e masave të posaçme për pastrimin e

plazheve nga mbetjet e ngurta, me qëllim për përmirësimin e gjendjes në zonat bregdetare.

Kontrolli i Lartë i Shtetit realizon ruajtjen dhe mbrojtjen e interesave mjedisore të vendit, jo vetëm nëpërmjet auditiveve të performancës(të tilla mjaft të suksesshme, si auditivi i administrimit të mbetjeve urbane ne Bashkinë e Fierit, menaxhimi i mbetjeve spitalore, etj.), por edhe nëpërmjet këqyrjes së kujdesshme dhe të hollësishme gjatë auditiveve të rregullshmërisë dhe përputhshmërisë të bashkive dhe komunave të Republikës. Ky proces është në vijimësi dhe gjetjet dhe rekomandimet e KLSH janë një gur prove dhe moment përgjegjësie për qeverisjen vendore, në përpjekjet e saj për administrimin cilësor të aseteve mjedisore të vendit.

¹ *Shkrime të tjera të botuara nga Mimoza LLOJI dhe Shefki JAUPI për periudhën Janar–Qershor 2014:*

- *Niveli i menaxhimit publik dhe KLSH.*
(Botuar në gazetën “Telegraf”, më 08 maj 2014.)